

---

## Tu mirupafshim, vëlla!

(Tregim)

Maji derdhej i plotë shëtitores ndanë liqenit, aromat e blirëve, këngët e zogjve, fëshfërima e ujit më kishin thithur me magjinë e tyre.

Zilja e telefonit më nxori nga përhumbja.

- Festimin e kanë sjellë në spital, është shumë sëmure, - tha Nazari, im vëlla, i vogli.

Një gropë m'u hap në fund të barkut, maji u nxi, u bë sterrë. Nuk e di nëse e futa celularin në xhep, madje as e pashë rrugën ku shkelja, derisa u gjenda në sallën e urgjencës para shtratit të tij midis dy mbajtëse serumesh. Mbi ballë, hundë, faqe sumbulla djersë shndrinin si margaritarë të ftohtë. Mustaqet i qenë shprishur. Ferdania dhe vajzat, Juli, Ana, Nevila ishin nemitur nga e keqja.

- Ç'ndodhi? - e pyeta me gjysmë zëri.

Mblodhi vetullat për të thënë se nuk e dinte.

- Tre vena të bllokuara, - më pëshpëriti në vesh mjeku, - duhet ta shpini sa më parë në Tiranë ose Ohër t'i vendosin unaza.

- Po ju?

- Këtu s'kemi ç't'i bëjmë.

Nuk e di si u gjend një ambulancë shkatarraqe. E hipëm nxitimthi bashkë me serumet dhe një infermier, u nisëm në Ohër. Nuk do ta harroj kurrë atë udhëtim skëterre. Festimi jepte e merrte mes dhimbjesh të llahtarshme, Ferdania i mbante kokën, Juli ënjtej së qari, Nazari i thërriste shoferit të nxitonte...

I ri në moshë, pa sëmurrur kurrë, fizik për t'u pasur zili, kurajë heronjsh, e pamundur të besoja se mund të na ikte. E shoqja, vajza, vëllai ndiqnin shprehjet e fytyrës sime, e ndjeja se donin të më pyesnin, po ç'mund t'u thosha! Lotët më kishin zënë grykën, fjalët nuk dilnin.

Mbi të gjitha duhet ta mbaja veten në sytë e tyre.

- Nuk po merr serum, - tha Ferdania e tmerruar.

Vështrova nga infermieri, e pyeta me sy.

- Ndodh, - tha ai.

Shpresa u rikthye.

- Si je, vëlla? - e pyeta sa më qetë munda.

Po zëri m'u drodh.

- Mos pyet! - pëshpëriti ngadalë.

Mezi e dëgjova. Fytyra e zverdhur, sytë e ikur, çehrja e prishur ulërinin.

- Shpejt! - i bërtiti Nazari shoferit.

Derën e spitalit e hapi një meso burrë.

- Нема доктор, - tha në gjuhën maqedonase.

- Urgjencë! - i thirra, - lajmëroni mjekun.

Pas një vonese të shkurtër, po shkatërruese, e futën. Ne mbetëm në korridor me sytë nga dera e mbyllur. I gjithë personeli maqedonas madje edhe pacientët që prisnin.

---

---

Nga gjysmë errësira u ngrit në këmbë një plak i kërrusur me tespihe në dorë.

- Duhet të prisni, - përktheu, - ishallah i bëjnë derman.

- Kemi frikë, - i thashë, - është shumë sëmurë.

- Lërjani në dorë Allahut! - ngriti sytë lart.

Dëgjuam kërcitjen e derës, u ngritëm në këmbë si me komandë.

- Готово е! - tha një burrë me bluzën hedhur krahëve, - доцна си.

Pashë gjitha ankth nga plaku shqiptar. Ende shpresonim.

Ai ngriti sytë, psherëtiu gjithë dhimbje.

- Kurajë, o bir, - zvarriti fjalët, - yt vëlla është në xhenet tani!

Nazari m'u hodh në qafë, mbytur në lot, Ferdania ia dha kujës, Juli mbledhur një dorë shkulte leshrat. Nuk u mbajta, u bashkova me ta, e qamë me lot të hidhur vëllain që na iku për më pak se dy orë. U kthjem me trupin ende të ngrohtë në arkivol.

- Zot, përse?

Kjo pyetje na kishte ngrirë në buzë.

Dhe nuk dinim t'i jepnim përgjigje.

Ishte nata më e tmerrshme që kisha kaluar ndonjëherë. Ende s'më besohej, ja sa të çlodhej pak e do të ngrihej të bënte shaka si përherë.

Por jo!

Kujtimet m'u mblodhën në grykë, të nxehta, torturuese, të padurueshme, sikur donin të dilnin pa radhë të gjitha njëherësh...

Fëmijë pak nursëz, nuk duronte t'i bije më qafë se gjeje belanë. Tre vjet më i vogël, e pamundur ta largoja nga shokët e mi, ndonëse në atë moshë kaq ishin shumë. Tetë vjeç erdhi në këmbë nga fshati në qytet, më solli pesëdhjetë lek fshehur në një kuti shkrepëse të mos ia vidhnin rrugës. E mora në krahë, e përqafova ashtu i malluar siç isha larg njerëzve të mi.

Nuk u përpoq të çlirohej, lëvizi vetëm buzët.

- Lëshomë, se tallen shokët, - tha serioz.

Shokët e tij, ca qurrashë, zgërdhieshin pak më tej, pas kangjellave të konviktit.

Kishim atëherë një këndes shumë të bukur në shtëpi. Luante me të si ta kishte shok. Kur e therën për një sebep, qau tërë mbrëmjen mbi kokën e tij, madje me ligje si gratë nëpër vdekje. Nënës iu dhimbs, e mori me të mirë, i fshiu lotët, e ngushëlloi siç dinte ajo. Nuk u shtrua që nuk u shtrua, mbajti inat ditë të tëra. Vite më vonë në spital, u kullua mbi mua, si nënë e përvëlur për fëmijën. I qeshën sytë vetëm pasi u bind se isha shëruar.

Nipin e madh, Ergysin, e donte shumë se e rriti vetë.

- Do ta bëj doktor, - thoshte, - të më zgjatë ditët e pleqërisë.

Ergysi e mbaroi shkollën shkëlqyeshëm, po gjyshi nuk arriti të plakej, mjeku i ri s'mundi t'ia zgjaste ditët. E shoh djalin të qajë mbi kryet e tij dhe bota më duket më e padrejtë se kurrë.

Kështu mbeti gjer në fund, i ri, i bukur, gjithë sedër, nuk u plak kurrë. I ndershëm e nevrrik kur e sillte rasti, po i dhembshur si pak të tjerë.

---

---

- Nevrik me mend, - thoshte babi me sytë që i qeshnin nga krenaria...

Rreth arkivolit vajzat kujtonin copëza nga jeta e tij, festat familjare, lindjet e fëmijëve, piknikët, shakatë e tij dhe nuk pushonin së qari. Ferdania përpiquej t'u jepte kurajë, por e kishte të pamundur dhe së fundi qante bashkë me to.

Ja dy mbesat e vogla tetëmuajshe, të cilave gjyshi u zgjodhi emrat e bukur Alisa, dhe Luna, qeshin e argalisen si një ditë më parë në krahët e tij.

- Pushoni! - u thirri Ana si të ishin të ndërgjegjshme e të kuptonin.

Ato kujtuan se luante, e shtuan poteren.

Ana shtoi lotët...

Të nesërmen qindra njerëz të njohur e të panjohur shoqëruan arkivolin në varrezë. Kujtonin shakatë, bisedat me zemër në dorë, sillnin në mendje zërin e kthjellët e të qashtë dhe mezi besonin se nuk ishte më.

Rreth varrit të mbuluar mbetëm gjatë, shumë gjatë, vajzat, e shoqja, ne, dy vëllezërit e mbetur dhe tre motrat më të mëdha në moshë se ai. Të gjithë të përlotur, të gjithë zemërthyer!

- Ka jetë tjetër? - më pyeti Ana me sy të mjegulluar nga lotët.

- Nuk e di, - i thashë, - po nëse ka do të takohemi një ditë.

Si kurrë më parë, atë ditë besova në jetën tjetër, ku bashkohen njerëzit e ikur nga kjo jetë. Kisha shumë për t'i thënë, brenga të pambarimta më gërryenin shpirtin, madje edhe sot e kësaj ditë tetë vjet më vonë.

Hodha sytë mbi varrin e freskët dhe i thashë me bindje të plotë:

- T'u mirupafshim, vëlla!

E enjte, 28 maj 2020

---